



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:040639

Datë: 18.10.2021

Numri i dokumentit: 02289443

P.nr.10/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse – praktikante, Besarta Kurshumliu, në lëndën penale ndaj të pandehurit: F.U., për shkak të veprës penale: Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par. 2 lidhur me par. 1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.438/2020, të datës 13.01.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 14.10.2021 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Bogdan Spadijer dhe të pandehurit F.U., të njëjtën ditë e shpalli publikisht, ndërsa me datë 18.10.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.U., nga i ati U., e ëma Xh., e vajzërisë B., “data e lindjes”..., në Komunën e Mitrovicës, tani jeton në Mitrovicë, pensionit, i martuar, baba i gjashtë fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pagjykuar.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me datën 09.03.2020 në Mitrovicë, me vetëdije ka përdorur dokumentet e rrejshme ose të korrigjuara si të vërteta (origjinale), në atë mënyrë që deri sa ka qenë duke e ngasur automjetin për udhëtar të tipit..., me ngjyrë..., viti i prodhimit..., me targa të regjistrimit..., me numër të shasisë..., me rastin e kontrollit nga ana e njësisë policore është konstatuar se numri i shasisë është i salduar në këtë automjet dhe shihet edhe kiti, ku është njoftuar njësia e auto-krimeve në Mitrovicë dhe automjeti me vërtetim është marr (konfiskuar) nga i pandehuri.

Me këtë ka kryer veprën penale: Falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 3, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 43, 46, 47, 48, 49, 69 e 390 të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në afat prej një (1) viti, nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
2. Dënim me gjobë në shumë prej 300€ (treqind euro) të cilën shumë obligohet të filloj që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. I njëjti dënim me gjobë mund ta paguaj në tre (3) këste të barabarta. Pagesën e kështit duhet ta bëjë deri me datën 5 të muajit vijues për muajin paraprak. Në rast se i pandehuri nuk e paguan gjobën, atëherë kjo shumë e dënimit me gjobë mund t'i shndërrohet menjëherë në dënim me burgim sipas ligjit, sipas nenit 43 të KPRK-së.
3. Në mbështetje të nenit 283 të KPP, urdhërohet konfiskimi i sendeve dhe atë:
 - a. Vetura e markës..., ngjyrë..., viti i prodhimit..., me targa...; dhe
 - b. Leja e qarkullimit e Republikës së Kosovës...
4. Urdhërohet Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar që sendet e sekuestruar sipas pikës 2 të këtij aktgjykimi t'i shkatërrojë sipas procedurave ligjore, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
5. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
6. Kërkesë pasurore juridik nuk pati.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.438/2020, të datës 13.01.2021, ndaj të pandehurit F.U., për shkak të veprës penale: Falsifikim i dokumenteve, të parashikuar nga neni 390 par.1 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, më datë 14.10.2021, ashtu që i pandehuri deklaroi se e pranoi fajësinë për këtë vepër penale, shprehi pendim të thellë, i premtoj gjykatës se nuk do ta përsëris asnjëherë këtë vepër, e lus gjykatën që të merr parasysh rrethanat lehtësuese, faktin se jam pensionit, dhe të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se konsideroj se janë kushtet për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, pranimi është bërë pas sqarimeve të mjaftuara nga ana e gjykatës për pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë, andaj i propozoj Gjykatës që ta pranoi pranimin e fajësisë dhe këtë pranim të fajësisë ta merr parasysh si rrethanë lehtësuese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti policor, i datës 10.03.2020;

Deklarata e të pandehurit F.U. e dhënë në polici, datë 10.03.2020; Vërtetimi mbi sekuestrimin e automjetit; Raport i qendrës së automjeteve “Euro Lab” bashkë me fotografitë; Raporti i ekspertizës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë nr. AKF/2020/..., datë 24.07.2020; Libreza e qarkullimit..., për këtë automjet; Urdhër për sekuestrimin e automejtit, datë 13.05.2020. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i ‘u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, mirëpo mund të bëjë ankesë sa i përket lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par. 2 e lidhur me par.1 të KPRK, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-së. Si rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shpreh keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë sjelljet e njëjta, rrethanat personale, pasi që është pensionist, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin pasi që nuk evidentohet për ndonjë veprë tjetër penale.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burg të kushtëzuar dhe dënimi me gjobë ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par. 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata si në dispozitiv të Aktgjykimi ndaj të pandehurit e ka shqiptuar edhe dënimin plotësues – marrjen e sendit, dhe atë: automjetin dhe lejen e qarkullimit të Kosovës, duke marrë për bazë sigurinë juridike. Gjykata, konsideron se ka bazë për konfiskimin e këtyre sendeve, sepse nga provat që përmban kjo lëndë penale dhe pranimi i fajësisë vërtetohet se këto sende – automjeti dhe libreza ishte rezultat i kryerjes së veprës penale si në aktakuzë, e cila e për të cilën veprën penale është shpallur fajtor. Andaj, në kuptim të dispozitave të KPRK-së, i cili përcakton se sendet e përdorura apo të destinuara për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat janë rezultat i kryerjes se veprës penale do të konfiskohen, andaj për shkak të këtyre konstatimeve gjykata ka qenë e obliguar që të vendos si në dispozitiv të Aktgjykimit që sendet e përdorura të merren - konfiskohen, për shkak edhe të konstatimeve të cekura më lartë, në të kundërtën do të legalizohen veprimet e paligjshme të ndërmarrura mbi këto sende dhe rezultatet e këtij sendi, si nën dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike, Gjykata ka vendosur duke qenë se në aktakuzë nuk kishte palë të dëmtuara të propozuar.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 463 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.10/2021, datë 18.10.2021
2020:040639, 18.10.2021

Procesmbajtësja
Besarta Kurshumliu

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimet të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.